



ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Bordi i Entit Rregullator të Energjisë, në mbledhjen e tij të datës 28.12.2020, mori në shqyrtim praktikat e përgatitura nga drejtoritë teknike e ERE-s, dhe u shpreh si më poshtë:

1. Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “Ageta” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga Hec “Borie – Lurë 1” me kapacitet të instaluar 1800 kW.
2. Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “Ageta” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
3. Mbi disa ndryshime në vendimin e bordit të ERE-s nr. 179, datë 08.11.2017, “Mbi çertifikimin e shoqërisë “Operatori i Kombinuar i gazit natyror” Albgaz sh.a.”, i ndryshuar.
4. Për një ndryshim në vendimin e bordit të ERE nr. 187 datë 10.11.2017, “Për licencimin e shoqërisë Albgaz sh.a. në aktivitetin e shpërndarjes së gazit natyror”, i ndryshuar dhe një ndryshim në vendimin e bordit të ERE nr. 188 datë 10.11.2017, “Për licencimin e shoqërisë Albgaz sh.a në aktivitetin e transmetimit të gazit natyror”, i ndryshuar.
5. Mbi fillimin e procedurës për miratimin e programit të përputhshmërisë së Operatorit të Sistemit të Transmetimit për gazin natyror, “Albgaz” sh.a..
6. Mbi shfuqizimin e vendimit të bordit të ERE-s nr. 140, datë 21.08.2020 “Mbi rishikimin e vendimit të bordit të ERE-s nr. 86, datë 12.05.2020, “Mbi refuzimin e kërkesës së shoqërisë “Solaris Power” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”.
7. Për miratimin e “Rregullave për monitorimin e tregut të gazit natyror” në Shqipëri.
8. Për miratimin e “Kodit të matjes së gazit natyror” në Shqipëri.
9. Mbi fillimin e procedurës për të miratuar “Kushtet për të licencuarin e ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik për sektorin e gazit natyror” në Shqipëri.
10. Mbi fillimin e procedurës për miratimin e “Rregullave të funksionimit të terminalit të gazit natyror të lëngshëm (GNL)” në Shqipëri.

11. Mbi fillimin e procedurës për miratimin e “Metodologjisë së llogaritjes së tarifës për shërbimin e rigazifikimit nga impiantet e GNL” në Shqipëri.
12. Mbi lënien në fuqi të vendimit të bordit të ERE-s nr. 94, datë 08.06.2020 “Mbi çmimin vjetor të blerjes së energjisë elektrike, që do t’u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi të energjisë elektrike për vitin 2020”.
13. Mbi fillimin e procedurës për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli, era dhe nga pjesa e biodegradueshme e mbetjeve të ngurta që shfrytëzojnë mbeturinat industriale, urbane dhe rurale për vitin 2020.
14. Mbi fillimin e procedurës për miratimin e metodologjisë për llogaritjen e detyrimit të energjisë së rinovueshme dhe procedurën për kompensimin e prodhuesve me përparësi të energjisë elektrike.
15. Mbi miratimin e “Rregullores për burimet dytësore të energjisë elektrike”.
16. Mbi shqyrtimin e kërkesës së Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë në lidhje me shtimin e shtojcës “e” në rregullat e përkohshme për mekanizmin balancues të energjisë elektrike të miratuara me vendimin e bordit nr. 193, datë 24.11.2017.
17. Mbi kërkesën e shoqërisë OST sh.a. për shtyrje të afatit të hyrjes në fuqi të vendimit të bordit të ERE nr.106, datë 02.07.2020.
18. Mbi miratimin e formularit të përditësuar të ankesave të klientëve të energjisë elektrike dhe gazit natyror.